



**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Për pozitën nr. 1 të shpallur sipas konkursit Nr. 2/426 të dt. 25/07/2024
dhe thirrjes publike plotësuese të dt. 17.09.2024

Fakulteti:
Lëndët:

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

1. Teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij
2. Legjislacioni dhe menaxhimi i cilësisë
3. Kontrolli i prodhimeve ushqimore
4. Higjiena dhe teknologjia e qumështit
5. Teknikat e paketimit dhe ruajtjes së ushqimeve
6. Analizat senzorigje (organoleptike) të ushqimeve
7. Ushqimet funksionale dhe nutraceutikët
8. Teknologjia e pasvjeljes,
9. Teknologjia e qumështit dhe prodhimeve të tij II.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
PRISHTINË

Pranuar	28.10.2024	24	viti
Nj. org.	Numer	Sasia	Vlera
06	307		

Kandidatët e paraqitur:

1. Bekir Bytyqi
2. Fatjona Fejzullahu
3. Altin Berisha

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UPHP nr. 2/254 të datës 25.07.2024, dhe të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë dhe të Veterinarisë, me nr. Protokoli 06/53 të datës 03.10.2024, është caktuar:

Komisioni vlerësues në përbërje:

1. Kryetar:

Prof. Asoc. Dr. Xhavit Ramadani
UPHP, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

2. Anëtar:

Prof. Dr. Muhamet Kamberi
UPHP, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

3. Anëtar:

Prof. Asoc. Dr. Alltane Kryeziu
UPHP, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
UPHP, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Dokumentet relevante:

- Statuti i Universitetit të Prishtinës, Nr. 08-V-770, datë 11.07.2024.
- Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UPHP nr. 2/254 të datës 17.07.2024.



- Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë dhe të Veterinarisë, me nr. protokollit 06/53 të datës 03.10.2024.

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidatëve:

1. **Bekir Bytyqi**

Ka lindur më 23.09.1993 në Leshan të Suharekës. Kandidati ka diplomuar në vitin 2016 në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", - departamentin e Teknologjisë Ushqimore me Bioteknologji, nivelin Bachelor, me notë mesatare 9.45. Studimet master i ka përfunduar në Universitetin e Debrecen-it, në drejtimin "Food Safety and Quality Engineering", me notë mesatare 4.88/5. Aktualisht është kandidat në nivelin PhD të studimeve në Universitetin e Debrecen-it, në Doctoral School of Crop Production and Horticultural Science. Kandidati PhD Bekir Bytyqi ka marrë pjesë në konferenca të organizuara nga Uni-Debrecen si dhe ka botuar tre punime shkencore si koautor në revista shkencore me njohje ndërkombëtare. Në vitin 2016 kandidati ka marrë pjesë në kursin profesional 9 mujor në lëmin e përpunimit të qumështit dhe ka fituar titullin specialist në industrinë e përpunimit të qumështit. Gjithashtu, në vitin 2015 ka kryer praktikën profesionale 1 mujore në sektorin e Kimisë ushqimore dhe mbetjeve veterinarë në laboratorin e ushqimit dhe veterinarisë. Prej 01. 07. 2020 e deri më tani është i angazhuar në qumështoren Sharri në Dragash. Kandidati ka përvojë si këshilltar në përgatitjen e kurrikulës për profilet profesionale nga fusha e ushqimit. Kandidati nuk ka ofruar dëshmi të punës në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë (pika V/h e konkursit) dhe mësimdhënie në përgjithësi, prandaj kërkesa e tij refuzohet.

2. **Fatjona Fejzullahu** ka lindur më 03.10.1995 në Prishtinë. Ka përfunduar studimet tri vjeçare të nivelit Bachelor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Drejtimi: Teknologji Ushqimore me Bioteknologji në Prishtinë, më 2016, me notë mesatare gjatë studimeve 9.76/ (max. 10), ndërsa studimet e nivelit Master në Szent Istvan University në Budapest (Hungari) më 2018, në programin Food Science and Technology Engineering, me notë mesatare 4.92/(max. 5). Në vitin 2018 në Hungarian University of Agriculture and Life Sciences në Budapest - Hungari, ka regjistruar studimet e doktoraturës në Departamentin Bioengineering and Fermentation Technologies dhe ka përfunduar me 06. 06. 2024 duke marrë titullin Doktor shkence. Gjatë studimeve të nivelit bachelor, master dhe doktoraturë, kandidatja ka marrë pjesë edhe në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në fushat e profesionit që ka. Për më tepër Kandidatja PhD Fatjona Fejzullahu ka marrë pjesë edhe në konferenca të ndryshme ndërkombëtare si dhe ka botuar 3 punime shkencore në revista shkencore në platformat e indeksuara sipas kërkesave në Statusin e Universitetit të Prishtinës. Msc. Fejzullahu ka krijuar



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

përvojë pune 5 vjeçare në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë. Aktualisht mbanë ushtrimet në kuadër të Departamentit Teknologji ushqimore me bioteknologji (TUBT) në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë në të gjitha lëndët e përshkruara në pikën 1 të konkursit në fjalë.

Altin Berisha ka lindur më 06.01.2001. Studimet Baçelor i ka përfunduar në vitin 2022 në Universitetin e Prishtinës në programin Teknologji ushqimore me Bioteknologji, me notë mesatare 9.17. Studimet master i ka përfunduar në vitin 2024 në Hungari-Universiteti i agrikulturës dhe shkencave natyrore, në drejtimin Shkencat e ushqimit dhe inxhinierie e tekonojgjisë me notë mesatare 4.16/ 5. Kandidati ka listuar përvojë pune në disa fabrika të përpunimit të qumështit. Megjithatë, kandidati nuk ka ofruar dëshmi të punës në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë (pika V/h e konkursit) dhe mësimdhënie në përgjithësi, prandaj kërkesa e tij refuzohet.

Bazuar në dokumentacionin e prezantuar nga tetë kandidatët që kanë aplikuar për pozitën 1, nga ana administrative është konstatuar se kandidatët kanë dorëzuar dosjet e plota me përmbajtjen e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas konkursit.

Rekomandim:

Bazuar në këtë që u theksua më lartë, Komisioni vlerësues konstaton se kandidatja **Dr.sc. Fatjona Fejzullahu** i plotëson kushtet për zgjedhje në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për mbajtje të ushtrimeve. Kandidati MSc. **Bekir Bytyqi** nuk i plotëson kushtet për shkak se nuk ka ofruar dëshmi për punën në mësimdhënie në arsimin e lartë. Kandidati Msc. **Altin Berisha** nuk i plotëson kushtet për shkak se nuk ka ofruar dëshmi për doktoratën e regjistruar, nuk ka punime shkencore të publikuara dhe nuk ka ofruar dëshmi për punën në mësimdhënie në arsimin e lartë.

Propozimi përfundimtar

Në bazë të dokumentacionit të ofruar, dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës (neni 147 pika 3.9, neni 148, pikat 4.5 dhe 6) si dhe Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës nr. UP-së nr. 2/254 të datës 17.07.2024 (neni 7 pika 3), komisioni vlerëson se kandidatja Dr. sc. **Fatjona Fejzullahu** në krahasim me kundër kandidatët plotëson të gjitha kriteret e parapara me rregullore (ka notë mesatare më të lartë në studimet Bsc dhe Msc, ka të përfunduara studimet e doktoratës, ka pesë vite që është e angazhuar si bashkëpunëtorë e jashtme në FBV (TUBT), ka të botuar tre punime shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara, ka marrë pjesë në trajnime profesionale dhe në konferenca ndërkombëtare të fushës së studimit dhe punës, ka moshë më të re etj.).



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Bazuar në argumentet e lartpërmendura, komisioni vlerësues i propozon Këshillit të FBV angazhimin e Dr.sc. **Fatjona Fejzullahut** si bashkëpunëtorë të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve në lëndët e shpallura në konkursin për bashkëpunëtorët e jashtëm, në UPHP nr. 2/426 të datës 25.07.2024, thirrjes publike plotësuese të dt. 17.09.2024, dhe të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë dhe të Veterinarisë, me nr. Protokoli 06/53 të datës 03.10.2024, Pozita 1.

Prishtinë, 28.10.2024

Komisioni vlerësues

Kryetar *Prof. Asoc. Dr. Xhavit Ramadani*

Anëtar *Prof. Dr. Muhamet Kamberi*

Anëtare *Prof. Asoc. Dr. Alltane Kryeziu*



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore	ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.				
1	Bekir Bytyqi	PhD kand.	-	3	-	9.45 (max.10)	4.84 (max.5)	-	23.09.1993	-	Jo	Jo
2	Fatjona Fejzullahu	Dr.sc.	-	3	-	9.76/10	4.92 (max.5)	-	03.10.1995	5	Jo	Po
3	Altin Berisha	MSc.	-	-	-	9.17 (max.10)	4.16 (max.5)	-	06.01.2001	-	Jo	Jo